



Implemented by:  
**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



## THIRRJE PËR MENTORË SOCIAL

**Titulli:** Thirrje për mentorë socialë në kuadër të projektit: “Promovimi i mentorimit social si një qasje partneriteti ndërsektorial për nxitjen e punësimit të grupeve të disavantazuara”.

**Vendi:** Bashkia Tiranë

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC) kërkon të angazhojë një grup prej 10 -12 profesionistë që do të punojnë si mentorë socialë për projektin **“Promovimi i mentorimit social si një qasje partneriteti ndërsektorial për nxitjen e punësimit të grupeve të disavantazuara”**.

### Organizata

GADC është një organizatë lider në Shqipëri dhe në Evropën Juglindore, me mbi 25 vite përvojë në adresimin e çështjeve thelbësore të lidhura me të drejtat e grave dhe përfshirjen sociale. Fushat kryesore të ekspertizës janë: forcimi i kapaciteteve të OJF-ve dhe krijimi i nismave të reja; avancimi i të drejtave të njeriut, anti-diskriminimit dhe barazisë gjinore; sigurimi i angazhimit të gjerë qytetar në zhvillimin demokratik. Përmes bashkëpunimeve të suksesshme me aktorë të ndryshëm, si organizata dhe rrjete rajonale e ndërkombëtare, institucione publike në nivel qendror e vendor, sektorin privat dhe mediat, GADC punon fort, mes të tjerash, edhe për fuqizimin ekonomik të grupeve të cënueshme.

### Projekti

Ky projekt po zbatohet nga GADC në partneritet me **Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)** në kuadër të projektit rajonal të GIZ, *“Përfshirja Sociale e Grupeve të Disavantazuara në Ballkanin Perëndimor (SoRi III)”*, i cili po zhvillohet në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Në Shqipëri ky projekt zhvillohet nga GADC.

Projekti synon të zgjerojë përdorimin e mentorimit social dhe ta promovojë atë si një dialog ndërsektorial që nxit punësimin e personave nga grupe të disavantazuara. Projekti fokusohet në tre qëllime:

- Forcimi i mundësive të punësimit për personat e disavantazuar përmes mentorimit social.
- Rritja e kapaciteteve të kompanive për të mundësuar përfshirje në punësim për grupet e disavantazuara duke zbatuar qasjen e mentorimit profesional dhe duke krijuar lidhje me mentorët socialë.
- Advokimi për institucionalizimin e mentorimit social si një qasje inovative ndaj nxitjes së punësimit në sistemin e mbrojtjes sociale, duke ndërgjegjësuar aktorët përkatës në nivel lokal dhe kombëtar.

### Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët:

Aplikantët duhet të demonstrojnë njohuri të mira të njohjes së situatës së punësimit dhe mundësive të punësimit në Shqipëri. Aplikantët duhet të njohin kuadrin ligjor dhe atë të politikave në lidhje me barazinë gjinore dhe mbrojtjen sociale në Shqipëri. Aplikantët duhet të jenë persona të orientuar drejt rezultateve, duke demonstruar aftësi të shkëlqyera komunikimi, facilitimi dhe prezantimi. Kriteret e tjera përfshijnë:

- **Arsimi:** Të kenë përfunduar arsimin e lartë në punë/politikë sociale, psikologji, pedagogji, këshillim psikologjik ose familjar, këshillim karriere, burime njerëzore ose një profesion tjetër i shkencave shoqërore që ka të bëjë me fushën e shërbimeve sociale, punësimit, mbështetjes psikosociale dhe të karrierës, këshillimit, ose fusha të tjera të lidhura me to.
- **Përvojë pune:**
  - të paktën 1 vit punë në sferën e mbrojtjes sociale ose shërbimeve sociale. Eksperienca në mentorim social do të ishte e vlerësueshme.

#### **Aplikantët duhet të kenë:**

- Kompetencë profesionale dhe zotërim të tematikave.
- Aftësi shumë të mira komunikuese
- Aftësi analitike dhe aftësi në të shkruar
- Përvoja në projekte të financuara nga donatorë të ndryshëm dhe puna në mjedis ndërkombëtar do të konsiderohet si përparësi.
- Portofol njohurish inovative dhe historish suksesi.

#### **Aftësitë gjuhësore:**

Njohuri të shkëlqyera të dëshmuara të gjuhës angleze (në nivelin e punës), sepse trajnimi i mentorëve, takimet e komunitetit rajonal të shkëmbimit të përvojave mes mentorëve socialë, si dhe procesi i supervizimit do të jenë në gjuhën angleze. Ndërsa, realizimi në praktikë i mentorimit social do të bëhet në gjuhën shqipe.

#### **Afatet Kohore:**

Ekspertët do të angazhohen për një numër të caktuar ditësh pune në varësi të detyrave gjatë periudhës 1 Nëntor 2023 – 31 Maj 2024.

#### **Përshkrimi i detyrave :**

Mentorët socialë të përzgjedhur do të kenë këto detyra:

##### **1. Implementimi i mentorimit social në një cikël prej 12 muajsh:**

- Të marrë pjesë në procesin e trajnimit për rifitimin e njohurive mbi mentorimin social.
- Të përdorë në mënyrë aktive platformën e mësimi MOODLE.
- Të analizojë nevojat dhe kërkesat për punësim të personave nën mentorim.
- Të krijojë një plan pune për secilin person nën mentorim.
- Të vlerësojë gatishmërinë për punë të të mentoruarve përmes përdorimit të metodologjisë së mentorimit social.
- Të krijojë një plan individual për punësim dhe zhvillim për secilin person nën mentorim.
- Të sugjerojë mbështetje shtesë për avancimin e aftësive lidhur me punën, në përputhje me planin individual të personit nën mentorim.
- Të sugjerojë mbështetjen e duhur psiko-sociale për zbatimin e planit individual të parashikuar, nëse është e nevojshme.
- Të hartëzojë mundësitë e punësimit për secilin person nën mentorim, përmes komunikimit me sektorin e biznesit.



Implemented by:  
**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Gender Alliance for Development Center  
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

- Të vendosë marrëdhënie me bizneset lokale dhe të lidhë ekipin e projektit me personat e kontaktit nga kompani që mund të jenë të interesuara për të punësuar të mentoruarit.
- Të vlerësojë procesin e përshtatjes në vendin e punës të personit nën mentorim.
- Të bashkëpunojë me një mentor profesionist që do të katalizojë procesin e integritit pas hyrjes së personit të mentoruar në kompani.
- Të raportojë mbi progresin e secilit person nën mentorim dhe të vlerësojë punën e vet me secilin person nën mentorim.
- Të marrë pjesë në sesionet e supervizimit që janë pjesë e mentorimit social.
- Të marrë pjesë në organizimin dhe ofrimin e logjistikës për takimet me palët e interesuara.
- Të punojë në koherencë me mentorë të tjerë socialë nga rajoni, si dhe me aktorë të tjerë të identifikuar si të nevojshëm për përmirësimin e mundësive të punësimit të personave nën mentorim.

### Aplikimi

Dokumentat e aplikimit duhet të jenë **në gjuhën angleze** dhe të dërgohen me email tek: [gadc@gadc.org.al](mailto:gadc@gadc.org.al).

**Afati i fundit për aplikim është 8 shtator 2023 në orën 17:00.**

Aplikimi duhet të përmbajë:

- **CV**
- **Letër motivimi**
- **2 kontakte reference**

Aplikantët e përzgjedhur do të njoftohen për një intervistë dhe do të informohen për vendimin final